

Mr. Marjan Prenkaj

DISA ASPEKTE TË LUFTËS PËR AUTONOMI TË SHQIPTARËVE TË VILAJETIT TË KOSOVËS NË KOHËN E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Në frymën e kushtetutës së vitit 1877, Perandoria Osmane, bëri reformën administrative, duke formuar Vilajetin e Kosovës, i cili në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përbëhej nga sanxhaqet e Prishtinës, Prizrenit, Shkupit, Novi Pazarit dhe Dibrës.¹

Rreziku i copëtimit të këtyre viseve me shumicë të banuara me shqiptarë, fuqimisht ndikoi te personalitetet e njohura shqiptare të Vilajetit të Kosovës, për marrjen e vendimit për formimin e një organizate të përgjithshme politike e ushtarake me qendër drejtuese, e cila do t'i mobilizonte të gjitha forcat për t'i mbrojtur të drejtat e popullit shqiptar.

Përfaqësuesit shqiptarë të Vilajetit të Kosovës, dukshëm kontribuan në formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si një organizatë me karakter politik e ushtarak, me qendër drejtuese, e me degë përkatëse në viset e ndryshme të banuara me shqiptarë. Kështu, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u ndërtua, u zgjerua dhe u forcua në pikëpamje organizative, duke formuar degët e saj edhe në viset e Vilajetit të Kosovës, si në Prishtinë, Mitrovicën e Titos, Gjakovë, Vuçiternë, Preshevë, Shkup, Novi Pazar etj.²

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në këtë mënyrë, së bashku me degët e saj, meqë ushtronte funksionet e pushtetit ligjdhënës, ekzekutiv, gjyqësor, administrativ dhe ushtarak, jo vetëm që kishte pushtet të plotëfuqishëm, përveç të tjerash, edhe në viset e banuara me shqiptarë të Vilajetit të Kosovës, por ajo, duke qenë një lloj „shteti në shtet” dhe duke pasur mbështetjen e fuqishme të masave popullore, u bë faktor politik dhe ushtarak i rëndësishëm në periudhën e Krizës Lindore.³

Nga burimet e ndryshme të kohës, posaçërisht nga protestet e memorandumet, dërguar Portës dhe Fuqive të Mëdha prej shqiptarëve të Vilajetit të Kosovës, ende para se të nxirrej Kararna-

¹ Ismail Eren, *Stamparija Kosovskog vilajeta u Prištini (1877—1888)*, Gjurmime albanologjike, nr. 1, Prishtinë 1968, fq. 177.

² *Başbakanlık arşivi*, T. 1297. No. 1501. (BBA).

³ Ali Hadri, *Rëndësia historike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878—1881*, Horizontet e historisë, nr. 2, Prishtinë 1978, fq. 10.

meja, Talimati dhe Rozoluta, dëshmohej në mënyrë të plotë për veçoritë kombëtare e autonomiste të lëvizjes shqiptare të këtij Vilajeti. Kështu, në një thirrje dërguar sulltanit prej Prizrenit, në maj 1878, kjo lëvizje përshkohej nga ideja dhe nevoja e mbrojtjes së viseve të banuara me shqiptarë, si kusht i domosdoshëm për krijimin e një njësie autonome me shqiptarë dhe të përparimit të vendit: „(...) ne nuk dëshirojmë gjë tjetër-thuhej në thirrje veç përparimin, zhvillimin dhe lulëzimin e Shqipërisë, dhe besojmë se këto (...) mund të arrihen (...) me anë të respektimit të tërësisë të gjithë territorit tonë me formimin e gjithë Shqipërisë si një provincë e vetme, nën drejtimin e një guvernatori të përgjithshëm të emëruar nga Porta e Lartë, dhe më në fund me zbatimin e reformave serioze dhe të përshtatshme me nevojat e qytetërimit dhe me traditat kombëtare”.⁴

Më 15 qershor 1878, përfaqësuesit e viseve të mesme dhe veriore shqiptare, protestuan pranë qeverive të Fuqive të Mëdha, që të mos cenohen të drejtat kombëtare shqiptare, duke i bërë të ditur se „kombi shqiptar, qoftë mysliman, qoftë katolik, që ndryshon aq shumë prej sllavëve si nga kombësia, ashtu edhe nga feja, është njëzërit i vendosur të mbrojë atdheun e vet kundër rishikimit (ndarjes) të territorit që është projektuar si veprim në kundërshtim me historinë, me interesat e me dëshirat e tij”.⁵

Më 15 qershor 1878, Lidhja i dërgoi një telegram Portës së Lartë, duke ia tërhequr vërejtjen asaj përkitazi me vendosmërinë e shqiptarëve për mbrojtjen e integritetit kombëtar. Përveç tjerash, në telegram kërkohej që ajo të angazhohej në Kongresin e Berlinit për t'i mbrojtur interesat shqiptare. Në një mbledhje tjetër, gjatë kësaj dite, ishte vendosur, po që se Porta nuk do të ishte e aftë të mbronte çështjen shqiptare, atëherë do të pasonte shpallja e pavarësisë kombëtare.⁶ Po në këtë ditë, në një petecion, dërguar Portës nga Prizreni, shprehimisht thuhej se në këtë rast „interesat personale nuk merren në konsiderim (...). Lidhja jonë nuk ka mbështetje në fe, para së gjithash jemi shqiptarë”.⁷ Në një protestë tjetër, dërguar më 17 qershor Ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll, theksohej se shqiptarët e Vilajetit të Kosovës, pa dallim feje janë unikë dhe kërkojnë nga Qeveria e saj që të mos lejojë marrjen e vendimeve në Kongresin e Berlinit për copëtimin e viseve të banuara me shqiptarë. Këtë dokument, në emër të popullsisë shqiptare të besimit islam e nënshkruan 29 përfaqësues, ndërsa në emër të popullsisë shqiptare të besimit të krishterë 4 përfaqësues: Filipi e Pashku për Prizrenin, Tadeja për Pejën dhe Kola për Gjilanin.⁸

Në mbledhjet që u bënë nga fundi i korrikut në Janinë dhe Prizren, u vendos të kërkohej prej Portës bashkimi i viseve të ba-

⁴ Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878—1912*, Tiranë 1978, dok. 9.

⁵ *Po aty*, dok 14.

⁶ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë 1939, fq. 21.

⁷ Süleymân Kûlçe, *Osmanlı tarihinde Arnavutluk*, İzmir 1944, fq. 250.

⁸ Ilijaz Rexha, *Formimi, forcimi dhe zgjerimi i Lidhjes së Prizrenit sipas burimeve osmane (1878—1881)*, Vjetar, nr. XII—XIII, Prishtinë

nuara me shqiptarë dhe njohja e kombësisë shqiptare. Në projektin që Lidhja ia paraqiti valiut të Janinës dhe atij të Kosovës, parashtrohej nevoja e zbatimit të reformave dhe njëherësh njohja e viseve të banuara me shqiptarë, si një vilajet autonom. Përfaqësuesit e Lidhjes në Janinë për realizimin e idesë së krijimit të vilajetit autonom, kërkuan: forcimin e gjuhës me qëllim të sigurimit të ekzistencës kombëtare, bashkimin e të gjitha viseve në njësi (autonome) dhe zbatimin e reformave në viset e banuara me shqiptarë.⁹

Karakterit kombëtar i Lidhjes shihet nga të dhënat që dëshmojnë se ajo që në fillim kishte platformë politike dhe qëndrime të njëjta me Komitetin e Stambollit.¹⁰

Lufta për autonomi u zgjerua dhe karakteri kombëtar i saj u thellua edhe më tepër gjatë rezistencës së popullit shqiptar kundër misionit të Mehmet Ali Pashës në Prizren dhe vrasjes së tij në Gjakovë. Vrasja e marshallit turk në këtë vend bëri jehonë të madhe në viset e banuara me shqiptarë. Ajo shkaktoi diferencimin në radhët e lidhjes dhe thelloi armiqësinë ndërmjet popullit shqiptar dhe Portës. Sipas informatave që i kishte marrë ambasadori Layard nga autoritetet osmane, dihej se në këto vise gjendja ishte në flakë. Pas vrasjes së Mehmet Ali Pashës dhe suitës së tij, theksonte ky ambasador, „Porta është në rrëmuje dhe nuk di kë ta dërgojë në atë krahinë”.¹¹ Sipas raportit të Grenit, Lidhja „e shkaillmoi krejtësisht administratën lokale dhe, ndonëse masat energjike nuk u morën — shtonte ky diplomat — anarkia do ta kaplojë për së shpejti Shqipërinë Veriore”.¹² i njëjti informator na njofton se ushtria e rregullt, e cila ka qenë nën komandën e Mehmet Ali Pashës „kishte ngrehur krye dhe iu kishte bashkangjitur kryengritësve”.¹³ Madje, edhe regjimentet e tjera shqiptare nga radhët e ushtrisë turke të Epirit dezertuan dhe i shkuan në ndihmë në Prizren Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.¹⁴

Për shkak të gjendjes së krijuar, autoritetet osmane të Vilajetit të Kosovës, kërkonin nga qeveria që të dërgoheshin në Prizren tri tabore ushtarësh,¹⁵ meqë, siç njoftonte shtypi rus, ushtria turke nën presionin e kryengritësve u detyrua të strehohej në Kala dhe të hiqte flamurin nga muret e saj.¹⁶

Ngjarjet në Prizren dhe Gjakovë, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha, i krahasuan me gjendjen e krijuar në kohën e komunës së Parisit.¹⁷ I befasuar prej tyre, ambasadori rus në Stamboll, princi

⁹ Si në shënimin 4, dok. 28. 1981, fq. 150.

¹⁰ Slavko Dimevski, „Prizrenskata liga” spored izveštajite na stranski konzuli, Glasnik br. 3, Skopje 1975, fq. 106.

¹¹ Skënder Rizaj, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze, Prishtinë 1978, dok. 23.

¹² Po aty, dok. 24.

¹³ Po aty, dok. 25.

¹⁴ Po aty, dok. 33.

¹⁵ EBA, Yildiz Evr. Ta. 5. No. 1295.

¹⁶ Shemsi Ajvazi, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin rus, Prishtinë 1977, fq. 30 (temë e magistraturës në dorëshkrim).

¹⁷ Historia e popullit shqiptar II, Prishtinë 1979, fq. 135.

Llobanov, në kundërshtim me politikën tradicionale të qeverisë cariste ndaj shqiptarëve, nxitoi të pranonte se atje „po zhvillohej një frymë e vërtetë kombëtare, që duhej të merrej parasysh dhe që mund të çonte në pranimin e një pavarësie kombëtare (...) Shqipëria e pavarur — theksonte ky ambasador — do të ishte për Rusinë një Mal i Zi i dytë, i cili po të ishte nevoja, do të krijonte nën mbrojtjen e saj një pengesë për ambiciet austriake, greke, serbe dhe bullgare”.¹⁸

Në rrjedhën e rezistencës së fuqishme antiosmane, Komiteti i Stambollit e hartoi një program të ri, të cilin Sami Frashëri e botoi në gazetën e Stambollit „Intërpreti i Lindjes”, më 27 shtator të vitit 1878. Ky program, ashtu si dhe programi i parë i Lidhjes (Rezoluta), ka karakter kombëtar, meqë fuqimisht i shpreh kërkesat për autonomi, duke theksuar se në „Vilajetin Shqiptar”, krahas organeve arsimore-kulturore të formohen edhe ato administrative, civile e ushtarake, prej njësive më të vogla territoriale-administrative, nahijës, nënprefekturës e deri te organet më të larta, Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv të Vilajetit.¹⁹

Programi i muajit shtator u bë bazë e veprimtarisë së Lidhjes gjatë muajve tetor-nëntor 1878. Në mënyrë të organizuar dhe në bashkëveprim njëra me tjetrën, e diskutuan dhe e miratuan atë të gjitha degët e Lidhjes në veri dhe në jug të vendit. I reformuar nga shtatë në pesë pika, në formë kërkesash iu paraqiti Qeverisë Osmane gjatë periudhës 14 tetor — 8 nëntor, nga të gjitha degët e Lidhjes, duke filluar së pari nga Dega e Lidhjes së Dibrës.²⁰

Programi i miratuar i pasqyronte detyrat themelore të Lidhjes, duke kërkuar bashkimin e viseve të banuara me shqiptarë në një tërësi në vete, si kusht i domosdoshëm për zhvillimin politik, ekonomik dhe kulturor të vendit në shkallë kombëtare. Me këtë dëshmohej qartë se Lidhja ishte një organizatë politike-ushtarake shqiptare, e mbështetur plotësisht në parimin kombëtar.

Në këtë mënyrë, Lidhja u forcua organizativisht e fitoi një autoritet të padiskutueshëm në mbarë vendin. Në shumë vise të banuara me shqiptarë, funksionet administrative të vendit i morën degët e Lidhjes.²¹ Konsulli austro-hungarez nga Prizreni, njoftonte në janar të vitit 1879, se Lidhja ishte „plotësisht e pavarur nga Qeveria Turke dhe organet e saj”.²² Ajo tanimë, pushtetin e saj e kishte shtirë jashtë Vilajetit të Kosovës, Konsulli austro-hungarez nga Manastiri i raportonte Vjenës në shkurt të vitit 1879, se „Komiteti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ka derguar njerëzit e tij të besueshëm në fshatra të ndryshëm të Manastirit për t'i përhapur planet e Lidhjes-bashkimi i territoreve në një tërësi administrative.

¹⁸ Ligor Mile, *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. I*, (1876—1879), (Dokumente arkivash franceze), Tiranë 1978, dok. 148.

¹⁹ Si në shënimin 4, dok. 29.

²⁰ *Po aty*, dok. 32 dhe 34.

²¹ Irena Senkevič, *Albanija v period Vostcnogo krizisa*, Moskva 1965, fq. 123.

²² Haus-Hof und Staatsarchiv, Politisches Archiv, Wien (HHStA.PA), Prizren më 26 janar 1879.

Në shumicën e këtyre kazave-raportonte ky konsull — të banuara kryesisht me shqiptarë planet e Lidhjes janë pritur shumë mirë nga popullsia e vendit”.²³

Në rrethana të krijuara, Lidhja u përpoq që viseve të banuara me shqiptarë t’u jepte „një riorganizim të fortë homogjen e kompakt, shkruante Pashko Vasa — në përputhje me nevojat e saj dhe me karakterin e popullsisë së saj, që ajo të vihet me anë reformash rrënjësore, në gjendje të zhvillojë zgjuarsinë, pasurinë dhe fuqinë e vet ushtarake”.²⁴ Çështja e reformave administrative, me një sistem të veçantë administrativ e juridik u parashtrua që në Memorandumin e 20 qershorit, drejtuar Andrashit nga një grup personalitetesh të njohura shqiptare të Stambollit. Në këtë dokument, pos të tjerash, u kërkua edhe formimi i një komisioni të posaçëm, të përbërë nga shqiptarët, me qëllim që të „studiojë formën dhe të hartojë rregulloret e institucioneve të reja lokale, duke ua përshtatur karakterit, zakoneve dhe nevojave të vendit”.²⁵

Në programin e Komitetit të Stambollit, u parashtrua detyra që në gjykatat e „Vilajetit Shqiptar” të caktoheshin njerëz „që njohin gjuhën e vendit dhe të aftë të marrin vesh lutjet e kërkesat e njerëzve nevojatarë si dhe të flasin me ta pa përkthyes”.²⁶ Këtu theksohej nevoja e suprimimit të gjykatave të reja osmane, të formuara në kuadrin e reformave të Tanzimatit. Lëvizja kundër tyre shpërtheu në mars e prill 1879 në Prishtinë. Në rrethinën e saj për këtë çështje u mbajtën një serë mbledhesh, në të cilat sipas raporteve serbe, ndër të tjera, u vendos që nga sulltani të kërkohet krijimi i gjykatave popullore shqiptare. Lëvizja u përhap edhe në vise të tjera. Ajo në Prizren doli me kërkesa më të guximshme; kërkoi që në vend të gjykatave osmane të formoheshin ato shqiptare.²⁷

Kështu, më 19 maj 1879 Lidhja, në një tubim të saj vendosi të zgjeronte kërkesën për autonomi, duke kërkuar që, përveç institucioneve gjyqësore, të merrte në dorë edhe administratën shtetërore. Njëherësh u arrit pajtimi që të mos njihej autoriteti i pushtetit osman po që se refuzohen këto kërkesa.²⁸

Injorimi i tyre nga autoritetet osmane, ngjalli paknaqësi të madhe në mesin e popullsisë shqiptare të vendit, duke shkaktuar një sërë trazirash në Prizren dhe në viset e tjera të Vilajetit të Kosovës. Këtë e dëshmojnë edhe raportet e autoriteteve ushtarake serbe, të datës 1 qershor 1879, kur thuhej se „rreth Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit shqiptarët po revoltohen dhe për ta shuar kryengritjen për atje është nisur ushtria turke”.²⁹

²³ HHStA, PA, Manastir më 6 shkurt 1879.

²⁴ Vassa Efendi, *La Verité sur l'Albanie et les Albanais*, Paris 1879, fq. 92.

²⁵ Si në shënimin 4, dok. 20.

²⁶ *Po aty*, dok. 29.

²⁷ Kristo Frashëri, *Lidhja e Prizrendit (1878—1881)*, Tiranë 1956, fq. 34—35.

²⁸ *Po aty*, 35.

²⁹ *Po aty*.

Në rrjedhën e këtyre ngjarjeve, Lidhja ndaj gjykatave osmane e shpalli bojkotimin, duke u bërë thirrje shqiptarëve të vendit që në të ardhmen t'u drejtoheshin vetëm gjykatave shqiptare. Madje u përcaktuan edhe ndëshkime për ata që do të paraqiteshin para gjykatave shtetërore osmane.³⁰

Më në fund, sulltani u detyrua të pranonte që në Vilajetin e Kosovës, me përjashtim të Sanxhakut të Shkupit, krahas gjykatave osmane të formoheshin edhe ato shqiptare. Mirëpo, përkundër vendimit të tij, gjykatat popullore shqiptare u formuan edhe në Kumanovë, Shkup dhe Preshevë.³¹

Dypushteti i krijuar ndërmjet organeve të Lidhjes dhe pushtetit osman në Prizren dhe në viset e tjera të Vilajetit të Kosovës, pati si rrjedhim atë se autoritetet osmane nuk kishin mundësi si përpara të nxirrnin ushtarë, taksa dhe të vendosnin për mbajtjen e nëpunësve apo për lirimin e të burgosurve.³² Andaj, Qeveria Osmane, për të rikthyer pushtetin e mëparshëm të plotfuqishëm, urdhëroi që ndaj shqiptarëve të Prizrenit dhe Prishtinës të përdoorej forca.³³

Për të shqyrtuar gjendjen e krijuar dhe për të shqyrtuar detyra të reja, Lidhja në fillim të korrikut 1879 e thirri mbledhjen e Këshillit. Nga burimet serbe, dihej se Lidhja në këtë tubim kishte marrë vendim që të burgoseshin të gjithë njerëzit e sulltanit po qe se shqiptarëve nuk do t'u njihej autonomia. Duke u bazuar në vendimet e kësaj mbledhjeje, në Mitrovicën e Titos, Prizren, Pejë, Prishtinë, Vuçiternë u bë grushtshteti dhe pushteti kaloi në duar të shqiptarëve.³⁴ Mirëpo, valiu i Vilajetit të Kosovës në ndërkohë mori masa efikase ndaj këtyre ngjarjeve. Sipas raportit të kapitenit anglez, Anderson nga Nishi, dihej se katër batalione të ushtrisë osmane kishin hyrë në Prizren.³⁵

Pavarësisht nga mungesa e burimeve për të ndriçuar këtë ngjarje në tërësi, mund të konstatohet se në këtë rast në Degën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ka mbizotëruar rryma turkomane ndaj asaj autonomiste, e cila me siguri i kishte ndihmuar ushtrisë osmane për të ripushtuar Prizrenin. Mirëpo, Lidhja ndaj rrymës turkomane në këtë rast veprroi në mënyrë të ashpër. Sipas një raporti të konsullit francez nga Shkodra, afër tetëqind burra nga krerët e Dibërës, Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Tetovës dhe Shkupit, së bashku me përfaqësuesit e malësive të këtyre qyteteve u takuan në fshatin Rugovë. Në këtë kuvend mjaft rrept u qortuan përfaqësuesit e Prizrenit, të cilët, duke mos i mbajtur zotimet e tyre, lejuan që Prizreni të pushtohej nga trupat qeveritare.³⁶

³⁰ *Po aty.*

³¹ Jovan Hadži-Vasiljević, *Arbunasku liga, Arnautsku kongra*, Beograd 1909, fq. 93.

³² Masar Kodra, *Lidhja e Prizrenit shikuar nga aspekti i disa dokumenteve britanike më 1878—1881*, Kosova, nr. 3, Prishtinë 1975, fq. 53.

³³ Si në shënimin 27, fq. 35—36.

³⁴ *Po aty.*

³⁵ Si në shënimin 11, dok. 52.

³⁶ Archive du Ministère des Affaires étrangères, Correspondence politique consulaire et commerciales (AMAE, CPC), Shkodër shtator 1879).

Megjithatë, përkundër përçarjes në radhët e Lidhjes, përsëri nga kjo kohë, krahas saj filloi të fuqizohet edhe Dega e Lidhjes në Prizren, së bashku me ato të Vilajetit të Kosovës. Këtë fakt e dëshmon mbledhja që u mbajt në fillim të tetorit 1879, në Prizren, në të cilën pjesën më të madhe e përbënin delegatët nga territoret e ndryshme të Vilajetit të Kosovës: Prizreni, Gjakova, Peja, Novi Pazari, Mitrovica e Titos, Vuçiterna, Prishtina, Gjilani, Shkupi, Tetova, Gostivari Kërçova etj.³⁷ Lidhur me këtë kuvend, konsulli anglez nga Prizreni, njoftonte se të pranishmit u tubuan t'i „shqyrtojnë dhe t'i zgjidhin çështjet e atdheut të tyre”, sepse organet e pushtetit osman, të zgjidhura nga Porta, nuk gëzonin në këtë vend „as më të voglin autoritet në popull”.³⁸ Duke u nisur nga konsiderata se „Lidhja kohët e fundit, kish pasë filluar të marrë pjesë aktive në administratimin” lokal me³⁹ qëllim që „t'i zgjidhte çështjet e vendit dhe të popullit shqiptar”,⁴⁰ ky diplomat mendonte se nga veprimtaria e saj „varet fati i mbarë” shqiptarëve.⁴¹

Në tubimin e tetorit, u përpiluan kërkesat për autonomi, nëpërmjet të cilave u kërkua formimi i një principate të pavarur, e cila përveç lidhjeve konfesionale me sultanin në çdo pikëpamje tjetër duhej të ishte e pavarur nga pushteti osman.⁴² Meqë, në këtë dokument, përveç të tjerash theksohej barazia e plotë e njerëzve pa dallim feje, duke mos lejuar kurrfarë persekutimesh fetare, nuk do mend të konstatohej se ky program përputhej me të gjitha tiparet dhe synimet e Lëvizjes Kombëtare në epokën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Duke u mbështetur në burimet e kohës, dihej se pushteti i Lidhjes, tanimë shtrihej në një territor prej Ibrit, duke përfshirë pjesën perëndimore të pellgut të Vardarit e deri në veri të Malit Pind.⁴³ Kjo dëshmohej edhe nga një raport i autoriteteve osmane të Vilajetit të Kosovës, kur thuhej se „popullsia e kazave që gjenden brenda Vilajetit të Kosovës, sikurse janë Gjakova, Peja, Luma, Dibra e Epërme dhe e Poshtme, e Malit dhe viseve të tjera të këtij Vilajeti që disa vjet me radhë nuk janë duke dëgjuar dhe pranuar urdhëresat e Pushtetit Qendror (Osman) dhe janë vazhdimisht në kryengritje e sipër”.⁴⁴

Fuqizimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Prizren dhe në viset e tjera të Vilajetit të Kosovës, krahas pranisë së forcave ushtarake osmane, i shtyri personalitetet e njohura shqiptare që për-

³⁷ Irena Senkevič, *Iz istorii osvoboditelnoj borbi v Zapadne Makedonije i Kosovo v 1878—1881*, Slavjenskoe Istočnikovedenie Moskva 1956, fq. 98.

³⁸ Public Record Office, Forin Office (PRO,FO), Prizren, më 22 shtator 1879.

³⁹ *Po aty*, më 20 shtator 1879.

⁴⁰ *Po aty*.

⁴¹ *Po aty*, më 28 shtator 1879.

⁴² *Po aty*, më 4 tetor 1879.

⁴³ A. Lainović etj., *Francuski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod*, Skopje 1969, fq. 117—121.

⁴⁴ Ilijaz Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane*, Prishtinë 1978, dok. 20.

sëri të shqyrtonin çështjen e ekzistencës së mëtejme të gjykatave shtetërore osmane. Dega e Lidhjes në Prizren, në fillim të vitit 1880, nga autoritetet osmane kërkoi të abrogoheshin këto gjykata.⁴⁵ Rezistenca e popullsisë shqiptare të Prizrenit kundër institucioneve gjyqësore osmane ka qenë e lidhur ngushtë me luftën e saj ndaj administratës turke në përgjithësi, e cila në këtë kohë gjendej në rrënujë nga anarkia dhe korrupsioni i përmasave të gjera. Konsulli anglez nga Prizreni, duke ndriçuar këtë gjendje, shkruante se „nuk më mbetet tjetër përveç të mendoj për gjendjen e dhimbshme, nëpërmjet të cilës zhvillohen çështjet në këtë vend. Një vend që ndodhet gati në zemër të Evropës (...) të bie kaq poshtë sa të bëhet skenë e persekutimeve, padrejtësive, mjerimit (...) të gjitha këto mjerime të këtij populli kaq bujar -- shkruante ky konsull — nuk janë tjetër, përveç neglizhencës e pafalshme e një korrupsioni që drejtohet nga vetë qeveria turke”.⁴⁶ Nën presionin e 6.000 luftëtarëve të Degës së Lidhjes në Gjakovë dhe të nditur prej Ymer Prizrenit, në mars të vitit 1880 nga Prizreni u larguan shtatë nëpunës të akuzuar për korrupsion dhe krime të tjera të bëra ndaj popullsisë së këtij qyteti.⁴⁷ Kështu, urrejtja ndaj aparatit shtetëror të korruptuar u shndërrua në veprime të armatosura ndaj pushtetit osman. Atëbotë, afër Prizrenit u sulmuan dhe u çarmatosën katër batalione të ushtrisë turke.⁴⁸ Ndërsa në afërsi të Shtimjes rreth 3.000 luftëtarë pritnin rast të volitshëm për të sulmuar Prizrenin, në mënyrë që aty të shpallin pavarësinë kombëtare shqiptare. Autoritetet ushtarake osmane, duke parë rrezikun që në këtë rast u kanosej nga kryengritësit shqiptarë, u dolën atyre përpara të fshatit Krush. Me rastin e përleshjeve të armatosura, ushtria turke arriti të ndalte sulmin e tyre.⁴⁹

Rezistenca e fuqishme antiosmane pati si rrjedhim thellimin e mëtejme të luftës për autonomi. Sipas një raporti të konsullit austro-hungarez, në mars të vitit 1880, u bë riorganizimi i Lidhjes, duke ardhur në krye të saj tre persona të rinj: Ali Ibra nga Gashi, Haxhi Jonuzi nga Prizreni dhe Sylejman Vokshi nga Gjakova.⁵⁰ Këtyre më vonë iu bashkua edhe Ymer Prizreni.

Në raportet e konsullit anglez nga Prizreni, theksohej roli gjithnjë më i madh që filloi të luante Ymer Prizreni në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.⁵¹ Në një raport të Muktar Pashës, dërguar nga Prizreni Kryeministrit në fillim të prillit 1880, ky personatet i njohur shqiptar përmendet si kryetar i Lidhjes. Nga kjo mund të konstatohej se Ymer Prizreni që nga kjo kohë gjendej në krye të kësaj organizate.⁵² Sipas të njëjtit raport, Lidhja i ki-

⁴⁵ BBA, Ta, Ra 1298.

⁴⁶ PRO, FO, Prizren më 24 mars 1880.

⁴⁷ Po aty, më 10 mars 1880.

⁴⁸ Po aty, 10 shkurt 1880.

⁴⁹ Si në shënimin 27, fq. 40.

⁵⁰ Shukri Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897—1912)*, Prishtinë 1978, fq. 39.

⁵¹ PRO, FO, Prizren më 30 mars 1880.

⁵² Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente osmane 1878—1881*, Tiranë 1978, dok. 37.

shte parashtruar vetes për detyrë të bënte suprimimin e administratës lokale të vendit, duke theksuar nevojën që në çdo qendër administrative nga radhët e Lidhjes të zgjedhej këshilli, kryetari, dy sekretarë dhe një gjyqtar.

Në këtë konstelacion rrjedhash u diskutua çështja e autonomisë gati në të gjitha viset e banuara me shqiptarë. Me iniciativën e Degës së Lidhjes së Shkodrës, më 17 prill 1880, në mënyrë soleme nga ky qytet u shpall autonomia shqiptare. Shpallja e saj në Shkodër u pasua edhe në vendet tjera. Më 14 maj 1880 në Prizren u bë grushtshteti kundër qeveritarëve turq. Kështu, nga qyteti u dëbua mytesarrifi, Ahmet Hilmi Pasha, me shumë nëpunës të administratës osmane. Pushteti kaloi në duar të Degës së Lidhjes së Prizrenit, duke emëruar për mytesarrif të qytetit Shaip Spahiun dhe nëpunës të tjerë shqiptarë në administratën e vendit. Lëvizja u përhap në Gjakovë dhe Pejë.⁵³

Në këtë mënyrë Dega e Lidhjes e Shkodrës dhe ajo e Prizrenit e realizuan autonominë me armë prej së poshti, pa pëlqimin e Portës. Këtë Dimitrije Tucoviçi e karakterizoi si grusht të përgjithshëm revolucionar.⁵⁴

Porta, e frikës nga rrjedha e ngjarjeve, krahas Lidhjes në Prizren, e formoi një organizatë fetare, e cila, e mbështetur në fanatizmin fetar, duhej të bëhej interpretuese kryesore e politikës së saj në këtë vend.⁵⁵ Mirëpo, tanimë i tërë pushteti ishte përqëndruar në duar të Lidhjes dhe kryetarit të saj, Ymer Prizrenit. Kjo dëshmohej nga raporti i konsullit anglez në Prizren, kur thuhej se „një personalitet me emrin Haxhi Ymer efendi është duke ushtruar një ndikim të madh në qytetin e Prizrenit (...) duke marrë pjesë aktive në rregullimin e çështjeve puñike, politike dhe juridike (...) është për t'u habitur-vazhdonte konsulli anglez-kur shohim se ky njeri jo vetëm që ka mbetur krejtësisht i lirë, por njëkohësisht ka marrë në duar tërë administratën e këtij vendit (...) Ndonëse nuk mban ndonjë funksion zyrtar, me përjashtim të atij të mësuësit, ai korrespondon me shifra telegrafike kudo që të dëshirojë.”⁵⁶

Sipas një raporti të valiut të Manastirit, dihej se në Prizren në qershor të vitit 1880 propagohej ideja e bashkimit të viseve shqiptare në një qeverisje, e cila gradualisht duhej të merrte formën e një shteti autonom. Në përputhje me realizimin e këtij qëllimi u ndërmorën masa për organizimin e ushtrisë dhe grumbullimin e ndihmave materiale.⁵⁷

Për të ngritur në shkallë më të lartë këtë platformë autonome në gjysmën e dytë të korrikut 1880 u bë një kuvend në Prizren. Në këtë tubim u mor vendimi që të kërkohet nga Porta krijimi i një vilajeti të njësuar shqiptar.⁵⁸

⁵³ Si në shënimin 27, fq. 42—43.

⁵⁴ Dimitrije Tucović, *Sròija i Arbanija*, Beograd 1945, fq. 60.

⁵⁵ HHStA. PA, Prizren më 9 qershor 1880.

⁵⁶ PRO, FO, Prizren më 12 qershor 1880.

⁵⁷ BBA, Ta. 1297, 81. No. 1104, Sadaret ma'ruzati.

⁵⁸ Skënder Rizaj, *Synimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878—1881)*. Gjurmime albanologjike, nr. 8—1978, Prishtinë 1979, fq. 176.

Në një mbledhje të bërë në Prizren, ishte vendosur, po qe se Porta do t'i refuzonte këto kërkesa, të sulmoheshin menjëherë objektet ushtarake. Lidhur me këto synime të Lidhjes, autoritetet ushtarake të Vilajetit të Kosovës e shihnin të arsyeshme që në këtë drejtim të ndërmerreshin masa ushtarake, nga se përndry she, siç theksonin ato, shqiptarët do t'u dilnin „prej dore“.⁵⁹

Lëvizja për autonomi e rrezikoi deri në themel ekzistencën e mëtejme të pushtetit osman në këto vise. Në gjysmën e gushtit të vitit 1880 nga Prizreni u larguan definitivisht nëpunësit e mbetur të gjykatave osmane.⁶⁰ Komiteti i Lidhjes i mori në duar të veta të gjitha punët administrative; i zgjedhte e i ndërronte nëpunësit dhe vendoste për konflikte gjyqësore.⁶¹ Konsulli anglez nga Selaniku raportonte se Lidhja në Vilajetin e Kosovës i ka „dëbuar shumicën e kajmekanëve e kadive dhe i ka telegrafuar Portës, duke refuzuar njohjen e emërtimit (në kohën e fundit) të Hilmi Pashës për mytasarrif të Prizrenit. Ky funksionar-vazhdonte konsulli — duhej të mbetej në Manastir, për të cilën pozitë ai pat shkuar vetë t'i raportonte valiut para se të merrte detyrën. Unë kisha parë njërin nga zyrtarët e pushuara nga puna, i cili ishte emëruar vonë për kajmekam të Rahovecit, në Sanxhakun e Prizrenit. Ai më siguri se auteriteti i Portës në këtë krahinë ishte shkatërruar plotësisht; mexhliet (kuvendet) lokale ishin suprimuar dhe se administrata në përgjithësi ishte zaptuar nga Lidhja“.⁶²

Gjatë muajit tetor 1880 udhëheqësit e Lidhjes erdhën deri te përfundimi se kishte ardhur koha që në viset e banuara me shqiptarë të shpallej autonomia kombëtare. Për këtë arsye më 20 tetor u thirr një kuvend në Dibër. Në këtë tubim rryma autonomiste kërkoi që të shpallej autonomia shqiptare. Mirëpo, rryma feudale, duke u frikësuar për pozitat e veta, e kundërshtoi këtë propozim.⁶³

Megjithatë, Kuvendi i Dibrës i shqetësoi organet e pushtetit osman. Auteritetet ushtarake të Vilajetit të Kosovës e njoftonin qeverinë se në „Kuvendin e mbajtur në Dibër është vendosur që në të ardhmën të mos jepen rekrutë dhe rezerva për ushtrinë turke“.⁶⁴

Në fund të vitit 1880 forcat ushtarake në Vilajetin e Kosovës ishin të pakta. Organet e mbetura nuk kishin mundësi të mblidhnin taksa dhe rekrutë.⁶⁵ Në forcat politike të vendit u shkaktua një grupim i ri. Kjo pasqyrohej nga përbërja e degëve të reja të Lidhjes, në të cilat gjithnjë e më tepër u rrit pjesëmarrja dhe roli i fshatarësisë.⁶⁶

⁵⁹ BBA, Ta. 12, No. 1501, Sadaret resmi ma'ruzati.

⁶⁰ Si në shënimin 37, fq. 102.

⁶¹ *Po aty*.

⁶² Si në shënimin 11, dok. 81.

⁶³ Si në shënimin 21, fq. 165—166.

⁶⁴ Si në shënimin 44, dok. 42.

⁶⁵ M a r j a n P r e n k a j, *Dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, Prizren, 1978, fq. 71 (temë e magjistraturës në dorëshkrim).

⁶⁶ Si në shënimin 52, dok. 109 dhe 110.

Në fund të dhjetorit 1880 u bë riorganizimi i Lidhjes, duke përfshirë edhe Këshillin Qendror, ku rryma autonomiste, e udhëhequr nga Ymer Prizreni, Syiejman Vokshi, Shaip Spahiu, Ali Ibra etj. arriti t'i merrte plotësisht në duart e veta pozitën udhëheqëse dhe shndërroi Lidhjen në një organ autonomist, kurse në bashkëpunim me Abdyl Frashërin dhe përfaqësuesit e tjerë, ky këshill e shpalli veten Qeveri të përkohshme.

Autoritetet ushtarake në Prizren, marrjen e pushtetit nga ana e shqiptarëve e karakterizuan si „shtet në shtet”, i cili sipas tyre ishte thelbi i një qeverie që në suazat e veta përfshinte punët e jashtme, të brendshme, financat dhe ushtrinë.⁶⁷

Qeveria e Përkohshme e detyroi ushtrinë turke të mbyllej në Kështjellën e Prizrenit. Vuri kontroll të plotë dhe në qytet vendosi një administratë të përbërë nga nëpunësit shqiptarë.⁶⁸

Ndërkohë Prizrenit iu bashkuan Luma, Gucia, Peja, Gjakova me rrethinë. Aktiviteti i Lidhjes mbizotëroi në Kosovë dhe më vonë u shtri në Kumanovë, Tetovë, Gostivar dhe Dibër.⁶⁹ Pushteti i saj, përveç qyteteve, përfshiu edhe fshatrat, duke i kushtuar rëndësi të posaçme marrëdhënieve të mira me popullsinë krishtere të vendit.⁷⁰

Evolucioni i konceptit të autonomisë, varësisht nga rrethanat e brendshme dhe të jashtme, gjatë kohës së Lidhjes shënoi ngritje e zbritje, duke kaluar në tri faza kryesore. Në fazën e parë është karakteristike kryesore e tolerancës së Lidhjes dhe të Portës për shkak të interesave territoriale, e cila përfundon me thellimin e armiqësisë së tyre gjatë vrasjes së komandantit turk Mehmet Ali Pashës. Veçoria e fazës së dytë dallohet me diferencimin shkallë-shkallë midis klasave dhe shtresave të ndryshme shqiptare në radhët e Lidhjes që u manifestua me largimin e herëpasëherëshëm të elementëve konservatorë, klerikalë dhe turkomanë nga gjiri i saj, gjë që si rrjedhim solli krijimin e gjykatave popullore shqiptare dhe të pushtetit të saj në një sërë qytetesh e fshatrash, duke shkaktuar përmbyse revolucionare të pushtetit osman në shume vise të banuara me shqiptarë. Në fazën e tretë u bë ndarja e plotë i feudalëve konservatorë nga Lidhja; dhe në këtë mënyrë dypushteti osmano-shqiptar u zëvendësua me atë të Qeverisë së Përkohshme, e cila krijoi reparte ushtarake dhe udhëhoqi një politikë në përputhje me kushtet e luftës, duke krijuar marrëdhënie të mira ndërmjet popullsisë së krishterë sllave dhe asaj shqiptare, deri me rivendosjen e pushtetit të Portës nga ana e Dervish Pashës.

⁶⁷ Si në shënimin 7, fq. 251.

⁶⁸ Si në shënimin 17, fq. 174. 5.

⁶⁹ *Po aty*, 174—175.

⁷⁰ Si në shënimin 65, fq. 72.

Mr. Marjan Prenkaj

**QUELQUES ASPECTS DE LA LUTTE POUR L'AUTONOMIE
DES ALBANAIS DANS LE VILAYET DE KOSOÏE AU TEMPS
DE LA LIGUE ALBANAISE DE PRIZREN**

R é s u m é

Les représentants albanais du Vilayet de la Kosovë contribuèrent ostensiblement à la formation de la Ligue albanaise de Prizren comme une Organisation politique et militaire, d'un centre principal avec des filiales dans les contrées diverses habitées par les Albanais.

Dans diverses sources de l'époque surtout dans les pétitions et les mémoires envoyés à la Sublime Porte et aux Grandes Puissances se témoignent bien les caractéristiques nationales et autonomistes du Mouvement albanais dans le Vilayet de Kosovë à l'époque de la Ligue albanaise de Prizren.

Le caractère national et autonomiste de ce mouvement s'élargit et s'approfondit pendant la résistance albanaise contre la mission de Mehmet Ali Pacha à Prizren et son assassinat à Gjakovë. L'assassinat du maréchal turc dans cette ville fit un grand écho dans diverses villes habitées par les Albanais. Et, cela donna lieu à la différenciation des forces politiques dans l'ordre de la Ligue, approfondissant ainsi l'inimitié du peuple albanais envers la Porte.

Au cours de cette résistance anti-ottomane, le Comité de Constantinople rédigea un nouveau programme, la Résolution a eu son caractère national car puissamment mettait en relief la requête de la revendication de l'autonomie. Ce programme devient une base de l'activité de la Ligue pendant les mois octobre-novembre 1879. Réorganisé de 7 en 5 points, ce document représentait les obligations élémentaires de la Ligue demandant l'unité des régions habitées par les Albanais dans une unité comme condition indispensable au développement politique, économique et culturel du pays au degré national.